



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:032511

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05593953

CA.nr.4109/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Nehat Idrizi anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit-propozuesit të masës së sigurimit L.....Ll....., të cilin e përfaqëson avokate S..... K..... S....., ndaj kundërshtares së sigurimit L..... A.....Ll....., me vendbanim në Rr. Ali Pashë Tepelena, objekti IVY, kati 5, nr. 19, Prishtinë, të cilën e përfaqëson avokat L..... V....., me adresë në Prishtinë, me objekt masë e sigurimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1309/2024, të datës 14.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **19.04.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditësit-propozuesit të masës së sigurimit L..... Ll..... nga Prishtina, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1309/2024, i datës 14.03.2024, **VERTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e ankimuar C.nr.1309/2024, të datës 14.03.2024 ka vendosur si vijon:

- I. APROVOHET pjesërisht** i bazuar propozimi i propozuesit L..... Ll..... ndaj kundërshtares së sigurimit L..... A..... Ll..... për caktimin e masës së sigurisë, ashtu që **CAKTOHEN** kontaktet në mes të propozuesit L..... L..... dhe fëmijëve të mitur L..... Ll..... e lindur me datë 28.08.2020, me numër personal 1253315977 dhe L..... Ll..... i lindur me datë 23.12.2016, me numër personal 1250254853, dhe atë çdo të premtë, duke filluar nga ora 14:00 deri në ora 15:30, ndërsa kontaktet do të realizohen në Qendrën për Punë Sociale në Prishtinë.
- II. OBLIGOHET** kundërshtarja e sigurimit L..... A..... Ll..... që t'i sjellë fëmijët e mitur për realizim të kontakteve në hapësirat e Qendrës për Punë Sociale, në ditën dhe orën si në pikën **I** të dispozitivit të këtij aktvendimi.

- III. REFUZOHET si e pabazuar** pjesa tjetër e propozimit të propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, me të cilën ka kërkuar që të caktohen kontaktet në mes të propozuesit dhe fëmijëve të mitur, dhe atë: vikendin e parë dhe të tretë të muajit, ku pranimit dhe dorëzimi i fëmijëve do të bëhet përmes Qendrës për Punës Sociale në ditën e premte, nga ora 15:00 dhe dorëzimi të bëhet në ditën e hënë ora 8:00, si dhe të mërkurën të i mundësohet propozuesit kontakti me fëmijët e tij pasi që fëmijët të përfundojnë shkollën, kopshtin dhe të njëjtit ti dorëzoj të nesërmen në shkollë, kopsht; ti mundësohet propozuesit kontakti me fëmijët në ditën e dytë të ditëlindjes së fëmijëve; ti mundësohet propozuesit kontakti me fëmijët ditën e dytë të festave shtetërore dhe fetare; ti mundësohet propozuesit kontakti me fëmijët 15 ditë të pushimeve verore dhe 15 ditë të pushimeve dimërore;
- IV.** Ky vendim për masë siguroese do të jetë në fuqi deri në marrjen e një vendimi tjetër lidhur me këtë çështje juridike.

Kundër këtij Aktvendimi brenda afatit ligjor paditësi-propozuesi i masës së sigurimit, përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta prishë aktvendimin e atakuar duke e kthyer në rigjykim dhe rivendosje.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi-propozuesi me datë 29.01.2024 ka parashtruar propozim për lëshimin e masës së sigurimit të kërkesëpadiës, ndaj kundërshtarës së masës. Duke vepruar sipas këtij propozimi gjykata e shkallës së parë pas zhvillimit të procedurës kontestimore, ka nxjerrë Aktvendimin e atakuar.

Në arsyetim të Aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se ka vlerësuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë, deklaratimet e palëve në seancë dëgjimore, dhe erdhi në përfundimin se propozimi për caktimin e masës së sigurimit është pjesërisht i bazuar. Gjykata fillimisht sjell në vëmendje dispozitën e nenit 297 të LPK- së e cila përcakton se, *a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.* Nga kjo dispozitë rezulton se masa e sigurimit mund të caktohet nëse përmbushen në mënyrë kumulative, e drejta subjektive

e pretenduar nga paditësi, dhe rreziku se pa caktimin e masës së tillë propozuesi mund ti vështirësohet realizimi i të drejtës subjektive. Në këtë kuptim, gjykata në bazë të provave të bashkangjitura propozimit dhe në bazë të deklarimeve të palëve, gjen se propozuesi i masës së sigurimit dhe kundërshtarja e sigurimit kanë lidhur martesë me datë 01.03.2016, dhe nga kjo martesë të njëjtit kanë dy fëmijë të përbashkët, L.... Ll....e lindur me datë 28.08.2020, me numër personal 1253315977 dhe L.....Ll.... i lindur me datë 23.12.2016, me numër personal 1250254853. Gjukata po ashtu gjen se raportet bashkëshortore në mes të palëve ndërgjyqëse kanë pësuar çrregullime, andaj edhe ka ardhur deri shkëputja e bashkësisë faktike dhe inicimi i procedurës së shkurorëzimit. Po ashtu nga deklaratimet e palëve dhe nga provat e bashkangjitura propozimit për caktimin e masës së sigurimit, gjykata gjen se, pas shkëputjes së bashkësisë martesore kundërshtarja e sigurimit ka refuzuar që të dërgojë fëmijët tek qendra për punë sociale në Prishtinë, për realizimin e kontakteve të propozuesit me fëmijët. Ky fakt vërtetohet edhe nga konstatimi zyrtar i lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Prishtinë, me nr. të lëndës 59/24, datë 23.01.2024, sipas të cilit konstatim zyrtar QPS ka konstatuar se, QPS ka bërë përpjekje për realizimin e kontakteve të fëmijëve ma babain – propozuesin, dhe kanë telefonuar disa herë kundërshtaren e sigurimit, që ajo ti sjell fëmijët për kontakt me propozuesin, por kundërshtarja e sigurimit nuk i është përgjigjur kërkesës së QPS-së. Po ashtu sipas këtij konstatimi zyrtar konstatohet se me datë 23.01.2024, kundërshtarja e sigurimit kishte deklaruar me telefon se nuk do ti sjellë fëmijët për kontakt me babain e tyre. Faktin se kundërshtarja e sigurimit ka refuzuar dërgimin e fëmijëve për tu realizuar kontakti në mes të propozuesi dhe fëmijëve të tij është pohuar edhe nga vet kundërshtarja e sigurimit, ku në përgjigjen rreth propozimit për caktimin e masës siguroese ka deklaruar se ajo dhe fëmijët kanë qenë të traumatizuar, andaj edhe kanë pasur nevojë për tu qetësuar, dhe kjo ka qenë arsyeja se pse nuk i ka dërguar fëmijët për kontakt me propozuesin. Nisur nga të gjitha këto fakte, gjykata vlerëson se në gjendjen e raporteve të krijuara në mes të palëve ndërgjyqëse, është e domosdoshme caktimi i masës së sigurimit, në kuptim të rregullimit të përkohshëm të kontakteve në mes të propozuesit dhe fëmijëve të mitur të palëve, kjo për faktin se nga të gjitha deklaratimet e palëve dhe nga provat e bashkëngjitura propozimit rezulton se raportet e bashkëshortëve janë acaruar, se ka pasur periudha kohore në të cilat kundërshtarja e sigurimit ka refuzuar që të realizohet kontakti në mes të propozuesit dhe fëmijëve. Në këtë kuptim, gjykata i referohet nenit 139 të Ligjit të Familjes (në vijim si LFK), i cili rregullon si në vijim: (1) *Nëse prindërit jetojnë ndaras , kujdesin prindëror e ushtron prindi me të cilin jeton fëmija nëse me këtë pajtohet prindi tjetër* (2) *Nëse në rastin e jetës së ndarë prindërit nuk merren vesh se me cilin prej tyre do të jetojë fëmija, vendimin lidhur me këtë gjë e merr gjykata kompetente, nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.* (3) *Në rastet kur prindërit jetojnë të ndarë, janë të shkurorëzuar ose martesa e tyre është e anuluar me vendim të gjykatës ose të organit tjetër kompetent, dhe fëmija i është besuar për ruajtje dhe edukim njërit prind, kujdesin prindëror e ushtron prindi të cilit i është besuar fëmija.* (4) *Gjatë kohës së ekzekutimit të masës gjyqësore, kujdesin prindëror e ushtron prindi të cilit me aktvendim i është urdhëruar të zbatojë masën,* si dhe në nenin, si dhe në nenin_125 paragrafi 2 pika b) LFK-së, ku parasheh se: *“Kur fëmija nuk jeton së bashku me prindërit, është e drejtë e tyre për t’i takuar rregullisht prindërit/ose prindin me të cilët nuk jeton fëmija.”* Bazuar në këtë dispozitë ligjore, është e drejtë e pamohueshme e secilit prind që të takojë fëmijët e tij, e po ashtu edhe më e rëndësishme është fakti se në rastet kur fëmija nuk jeton me prindërit, është e drejtë e tyre për të takuar prindërit ose prindin me të cilin nuk jeton. Andaj nisur nga fakti se kundërshtarja e sigurimit ka paraqitur

refuzim për ti mundësuar propozuesit takimin me fëmijët, gjykata vlerëson se është e bazuar kërkesa e palës propozuese që të caktohet masa e sigurimit për caktimin e kontakteve të propozuesit me fëmijët e tij të mitur. Këtë vendosje gjykata po ashtu e mbështet edhe në faktin se propozuesi ka paraqitur padi për besimin e fëmijëve, andaj gjykata caktimin e përkohshëm të kontakteve e konsideron si zgjidhje të përkohshme, që fëmijët deri në përfundimin e zgjidhjes së çështjes kryesore, të realizojnë kontaktet me babain e tyre, e po ashtu fakti se propozuesi nuk do ti mohohet takimi me fëmijët e tij, është pohuar edhe nga kundërshtarja e sigurimit dhe përfaqësuesi me autorizim i saj në seancë dëgjimore për masë siguroese. Vendosjen si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata po ashtu e mbështet edhe në anamnezën sociale të Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë, sipas të cilës anamnezë nga QPS është rekomanduar që kontaktet të realizohen çdo të premte nga ora 14:00 deri në ora 15 e 30 në zyrat e QPS-së, njësia 3, Prishtinë. Sa i përket pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vlerëson se, kërkesat si në pikën II janë të pabazuara, kjo për faktin se kontesti në mes të palëve është iniciuar me padi, dhe masa e sigurimit ka për qëllim vetëm sigurimin e asaj çka është e domosdoshme për fëmijët dhe prindin i cili nuk jeton me fëmijët, gjegjësisht vetëm caktimi i kontakteve deri në përfundimin e çështjes kontestimore sipas padisë kryesore. Në këtë kuptim, është i pabazuar kërkesa e propozuesit me të cilën ka kërkuar edhe caktimin e kontakteve gjatë vikendeve, dhe gjatë pushimeve verore dhe atyre dimërore, kjo për faktin se qëllimi i masës së sigurimit është ruajtje e gjendjes ekzistuese, dhe një vendosje e tillë siç është propozuar nga propozuesi në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, do të përbënte vendosje në tërësi të çështjes meritore, ndërsa dihet mirëfilli se masa e sigurisë nuk mund të paragjykojë, e as nuk mund të përfshijë vendosje të çështjes kryesore. Objekt shqyrtimi në këtë çështje juridike është vetëm vlerësimi i pretendimeve në lidhshmëri me plotësimin e kushteve për caktimin e masës së sigurisë në kuptim të nenit 297 par.1 të LPK-së dhe një vlerësim i tillë nuk e paragjykon edhe vendosjen e çështjes kryesore lidhur me kërkesëpadinë, e cila do të vendoset me rastin e procedimit të rregullt, pas ndërmarrjes së veprimeve të parapara procedurale, pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave të propozuara. Nga sa u tha më lartë e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 387.1 pika (l), lidhur me nenin 142.5 të LPK-së, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, sipas dispozitës së nenit 297, paragrafi 1 pika a) dhe b) dhe 297 paragrafi 2 të LPK, përcaktohet në mënyrë të qartë se “*masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se plotësohen në mënyrë kumulative tri kushte dhe atë: besueshmëria ekzistimit të kërkesës apo të së drejtës subjektive, ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe deponimi i garancionit*”. Në rastin konkret Gjykata e Apelit e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për caktimin e pjesërisht të masës së sigurimit, për shkak se gjykata e shkallës

së parë e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për aprovimin e masës së sigurimit. Kjo për faktin se ka rezultuar se propozuesi i sigurimit e ka argumentuar faktin se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë do të pamundësohet apo vështirësohet realizimi i kërkesës, përkatësisht i mohohet e drejta e kontaktit me fëmijët e tij, përmes QPS në Prishtinë, ndërsa për momentin është i bazuar përfundimi i saj që kërkesa për kontakt në vikendin e parë dhe të tretë të muajit në mes të propozuesit dhe fëmijëve të mitur të refuzohet, derisa raportet bashkëshortore të përmirësohen, e që do të ndikonte edhe në raportet prindë fëmijë dhe anasjelltas. Neni 145 par.1 të LF përcakton se *“ nëse fëmija jeton vetëm me njërin prind ose me prindin e tretë ose në një institucion, prindërit do të merren vesh për mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale me fëmijën. Në rast të kontestit, vendimin lidhur me këtë gjë e merr gjykata kompetente ”*. Në nenin 3 par.1 të Konventës mbi të drejtat e Fëmijës, (miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, e cila është e zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës sipas Nenit 22 të Kushtetutës së vendit), parashihet se *“Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese”*. Në bazë të dispozitave të lartcekura, Gjykata ka vendosur si në dispozitivit të këtij aktvendimi duke marrë për bazë të gjitha provat e administruara në procedurën pranë gjykatës së shkallës së parë, e sidomos duke marrë për bazë interesin më të mirë të fëmijëve të mitur, që për momentin kontakti i paditësit-propozuesit me fëmijët e tij të realizohet përmes QPS në Prishtinë, ashtu siç është vendosur në dispozitivin I dhe II të Aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson të pa bazuara pretendimet e palës ankuese se gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka vendosur si në dispozitivin III të Aktvendimit të atakuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktvendimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Kështu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktvendimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për të vendosur si në dispozitiv të të njejtit.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paraqitura në ankesë, por ka gjetur se janë të pathemelta dhe se nuk ndikojnë që gjykata të marrë një vendim ndryshe. Por, në rastin konkret gjykata ankimore ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura me ankesë për shkak se gjykata e shkallës së parë përfundimin e saj e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar për aprovimin e pjesërishëm të masës së sigurimit të kërkesëpadisë.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CA.nr.4109/2024, datë 19.04.2024

Numri i lëndës: 2024:032511
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05593953

Kryetari i kolegjit,
Ardian Ajvazi